



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

---

Numri i lëndës: 2019:163103  
Datë: 07.06.2024  
Numri i dokumentit: 05794211

Rev.nr.184/24

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nenad Lazic, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: V. M. nga fshati G., të cilin e përfaqëson Valon Sadiku avokat në L., sipas autorizimit, kundër të paditurve: A. T., K. T., si dhe S. T., D. T., L. E., M. E., të gjithë nga fshati G. e U., Komuna e L., të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Shpetim Sadiku avokat në L., dhe V. D. nga fshati K., Komuna e L., për kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me revizionin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3685/2021, të datës 22.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. Pranohet pjesërisht i bazuar revizioni i përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurit: S. T., D. T., L. E., M. E., të gjithë nga fshati G. e U., Komuna e L., NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3685/2021 i datës 22.02.2024, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.127/15 i datës 16.02.2021, në pjesën e kërkesëpadisë, sa i përket dëmit jomaterial, për cenimin e nderit dhe autoritetit, dhe gjykohet si në vijim: REFUZOHET e pabazuar kërkesëpadia e paditësit V.M. nga fshati G., Komuna e L., me të cilën ka kërkuar që të: Detyrohen të paditurit A. T., K. T., S. T., D. T., L. E., M. E., të gjithë nga fshati G. e U., Komuna e L., dhe V. D. nga fshati K., Komuna e L., që paditësit, për kompensimin e dëmit jomaterial, në emër të dhimbjeve të përjetuara shpirtërore, për cenimin e nderit dhe autoritetit me rastin e sulmit fizik, fyerjeve dhe ofendimeve në vende publik gjatë orarit të punës, të pësuar në incidentin e datës ..., t'i paguaj shumën në lartësi prej 500 €, me kamatë të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë, sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar, për një vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 16.02.2021, e deri në pagesën definitive.

II. Refuzohet i pabazuar revizioni i përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurit: A. T., K. T., S. T., D. T., L. E. dhe M. E., të gjithë nga fshati G. e U., Komuna e L., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3685/2021, të datës 22.02.2024, në pjesën tjetër të aktgjykimit të goditur.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.127/15 të datës 16.02.2021, është vendosur: I. Aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditësit V. M. nga fshati G., Komuna e L., si e bazuar, Obligohen të paditurit S. T., A. T., D. T., K. T., L. E., M. E. të gjithë nga fshati G. e U. dhe V. D. nga fshati K., Komuna e L., që në mënyrë solidare paditësit, në emër të shpërblimit të dëmit të shkaktuar në incidentin e datës ... në fshatin G. e U., t'ia paguajnë shumat si vijon: Dëmin j material në emër të dhimbjeve fizike - trupore shumën prej 1.500 €, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 1.200 €, në emër të dhimbjeve shpirtërore për cenimin e nderit dhe autoritetit me rastin e sulmit fizik, fyerjeve dhe ofendimeve në vende publik gjatë orarit të punës, shumën prej 3.500 €. Dëmin material në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 112 €, në emër të ndihmës dhe përkujdesjes së personit të tretë shumën prej 35 €, të gjitha këto shuma, me kamatë sipas shkallës së kamatës që paguajnë bankat për mjete të deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 16.02.2021, e deri te pagesa definitive. II. Në pjesën tjetër kërkesëpadia e paditësit më tepër se shumat e aprovuara, si në al. I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si dhe kërkesëpadia për terapi fizikale në shumë prej 60 €, refuzohen si të pabazuara. III. Obligohen të paditurit, që në mënyrë solidare t'ia paguajnë paditësit shumat nga pika I, e këtij aktgjykimi si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumën prej 3.723.20 €, ndërsa të paditurit S. T., D. T., L. E. dhe M. E., t'ia kompensojnë paditësit, në emër të përfaqësimit nga përfaqësuesi i përkohshëm edhe shumën prej 1.934.40 €, të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3685/2021, të datës 22.02.2024, është vendosur: I. Refuzohet pjesërisht e pathemeltë ankesa e të paditurve A. T., K. T., dhe S. T., D. T., L. E., M. E. të gjithë nga fshati G. e U., K. e L. dhe V. D. nga fshati K. Komuna e L., ndërsa pika e I-rë, nënpika 1 nën a), b) dhe nënpika e II-të, nën a) dhe b) të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore - Dega Lipjan, C.nr.127/15 të datës 16.02.2021, vërtetohet. II. Aprovohet pjesërisht e themeltë ankesa e të paditurve A. T., K. T., dhe S. T., D. T., L. E., M. E. të gjithë nga fshati G. e U., Komuna e L. dhe V. D. nga fshati K., Komuna e L., ndryshohet pjesërisht pika e I-rë, nën pika I, nën c) e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.127/15 i datës 16.02.2021, ashtu që gjykohet si vijon: Detyrohen të paditurit A. T., K. T., dhe S. T., D. T., L. E., M. E. të gjithë nga fshati G. e Ulët, Komuna e L. dhe V. D. nga fshati K., Komuna e L., që solidarisht në emër të dëmit të shkaktuar më datë 21.07.2011, në emër të dëmit jomaterial, për shkak të dhembjeve shpirtërore si rezultat i cenimit të autoritetit, nderit me rastin e sulmit fizik, t'ia paguaj shumën prej 500 €. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit për këtë kategori të dëmit mbi shumën e gjykuar refuzohet e pabazuar. II. Pika II, dhe III, e dispozitivit të aktgjykimit të lartpërmendur mbetet e pashqyrtuar.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor kanë paraqitur revizion të paditurit, për shkak shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni si i bazuar, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ac.nr.3685/2021 i datës 22.02.2024, si dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan C.nr.127/15 i datës 16.02.2021 të anulohen ndërsa kërkesëpadia e precizuar e paditësit të refuzohet si e pabazuar, apo çështja të kthehet në riprocedurë dhe rivendosje.

Përgjigje në revizion nuk ka pasur.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të paditurve është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, më datë 14.04.2015, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurve, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, duke kërkuar shumat e specifikuar më saktësisht si në parashtresën për precizimin e padisë të datës 12.01.2021.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit kundër të paditurve, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.127/15 të datës 16.02.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka administruar këto provave: raportin mjekësor të lëshuar nga QKMF, në Lipjan të datës 21.07.2011, raportin e QKUK-së QE, në Prishtinë nr.. të datës 21.07.2011, aktgjykimin penal P.nr.304/2011, procesverbalin e datës ..., ku ekspertet gjyqësor Dr. V. B. Ortopede-traumatologje dhe Dr. M.K. Psikiatër, kanë dhënë mendimin e tyre përkitazi me natyrën, dhe shkallën e lëndimeve të paditësit.

Ka theksuar se nga mendimi dhe konstatimi i ekspertëve gjyqësor Dr.V. B. ortopedë-tromatologje, Dr. M. K. psikiatër, të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 11.01.2021, në bazë të raportit të QKUK-së, QE në Prishtinë nr..., të datës 21.07.2011 dhe raporteve tjera specialistike dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, rezulton se paditësi në këtë rrahje ka pësuar lëndime trupore dhe atë: ndrydhje të kokës, hematome në regjionin temporal (prapa veshit të majtë) me madhësi prej 6x0.2 cm, prapa veshit të djathtë me madhësi 2x2cm, ndrydhje dhe gërvishjen e mollzës së djathtë të fytyrës me gjatësi 2cm, ndrydhje dhe gërvishje të regjionit të majtë të gjoksit me gjatësi 8x4 cm, lëndime këto të cilat karakterizohen si lëndime të natyrës së lehtë trupore. Nga këto prova të administruara gjykata vërtetoi se të paditurit në bashkëveprim më datën 21.07.2011 rreth orës 15.30, në fshatin G. e U., tek sh. e m., e kanë sulmuar fizikisht me grushta dhe mjete të forta paditësin në pjesë të ndryshme të trupit, i cili ka qenë në orar të rregullt të punës, në vend publik duke i kryere detyrat e punës në cilësi të punëtorit të Policisë së Kosovës, dhe me këtë rast i kanë shkaktuar lëndime trupore ndrydhje të kokës, hematome në regjionin temporal (prapa veshit të majtë) me madhësi prej 6x0.2 cm, prapa veshit të djathtë me madhësi 2x2cm, ndrydhje dhe gërvishjen e mollzës së djathtë të fytyrës me gjatësi 2cm,

ndrydhe dhe gërvishtje të regjionit të majtë të gjoksit me gjatësi 8x4 cm, mandej edhe e ka fyer me fjalët” çka u ba që për ditë po vini, A. nuk është këtu”, duke vazhduar me fjalët “jav q.... Policinë e nanës”etj, e me këtë në mënyrë të kundërligjshme i kanë shkaktuar edhe dëm material dhe jomaterial paditësit.

Sa i parket lartësisë së dëmit të pësuar jomaterial paditësit gjykata ia ka caktuar sipas çmuarjes të lirë, konform nenit 323 të LPK-së, nenit 190, 195.1 dhe 200 të LMD-së, dhe duke u mbështetur në konstatimin dhe mendimin e ekspertëve gjyqësor, përkitazi me natyrën dhe shkallën e lëndimeve të shkaktuara paditësit nga të paditurit, intensitetin dhe kohëzgjatjen, mandej duke pasur parasysh moshën e paditësit e lindur me ..., kriteret e kompanive të sigurimit, për caktimin e lartësisë së dëmshpërblimit, praktikës gjyqësore të gjykatave në Kosovë, të cilat për lëndime të ngjashme ua caktojnë shumat e dëmshpërblimit, dhe shumat e aprovuara për dëmin jomaterial, gjykata konsideron se paraqesin një satisfaksion ekuivalent me dëmin e shkaktuar paditësit.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 158, 190, 195, 198, 200, 206, 254 të LMD-së, (Gazeta Zyrtare e RSFJ-se nr.29), nenit 8, 143, 323 të LPK-së. Lidhur me shpenzimet ka vendosur në bazë të nenit 452 paragrafi 1 dhe 5 të LPK-së. Për kamatë ligjore ka vendosur në bazë të nenit 277 të LMD-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, të paditurit kanë paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.3685/2021, të datës 22.02.2024, ka vendosur që të ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit Gjykata e Apelit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por as me shkelje të cilat pretendohen me ankesë, përveç pjesës së gjykuar për dëmin jomaterial në emër të dhimbjeve shpirtërore si rezultat i cenimit të autoritetit të paditësit nga sulmi në detyrë zyrtare, e drejta materiale është zbatuar gabimisht për këtë gjykata e shkallës së dytë e ndryshoi aktgjykimin e ankimuar në këtë pjesë dhe vendosi sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe të parë, për kërkesat për të cilat është refuzuar revizioni, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ndërsa në pjesën që është ndryshuar vlerëson se aktgjykimet e instancave më të ulëta janë përfshirë në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve në revizionin e paraqitur nuk është referuar si bazë për parashtrimin e revizionit shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës sa i përket kësaj baze është kufizuar vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare në përputhje me nenin 215 të LPK-së, me ç’rast ka gjetur se aktgjykimi nuk është i përfshirë në shkelje që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt.

Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore (LPK-së), për pjesën e kërkesës për kompensimin e dëmit jomaterial për të cilat është refuzuar revizioni sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të bazuara.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjeshme të kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Po ashtu gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara.

Baza juridike e kërkesëpadsisë, që të paditurit të jenë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjënë mbështetje në nenin 154, 158 dhe 192 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit të datës 30 Mars 1978, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01 Tetor 1978.

Me nenin 154 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë t’ia kompensoj, në çoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij ”, me nenin 158 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia ”, ndërsa me nenin 192 paragrafi 1, përcaktohet se: “ Përcaktohet se i dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh nga sa do të ishte ka të drejtë vetëm për kompensim përpjesëtimisht të pakësuar”.

Baza juridike e kërkesëpadsisë, sa i përket pjesës tjetër të kërkesëpadsisë, në pjesën refuzuese të revizionit gjënë mbështetje në nenin 154 të LMD-së, për arsye se: Dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili si i tillë pranohet nga e drejta. Kështu dëmi përfaqëson dëmtimin që e pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jenë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Përndryshe dëmtimi përbën jo vetëm cenim të të drejtave, por edhe cenim të interesave, nëse ai është bërë në kundërshtim me të drejtën. Nga vetë përmbajtja e nenit 154 të LMD-së, rezulton se ai që i shkakton dëm tjetrit ka detyrim t’ia shpërblejë atë. Sipas kësaj dispozite për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e nevojshme të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktari i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore. Për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto parakushte: a) që të shkaktohet dëmi; b) që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm; c) të ekzistojë faji i dëmtuesit; d) që të ekzistojë aftësia delikatore dhe e) të ekzistoj lidhja kauzale ndërmjet veprimit/mosveprimit të kundërligjshëm dhe dëmit. Në këtë rast janë plotësuar këto parakushte ligjore për të ekzistuar përgjegjësia e të paditurve, për kompensimin e dëmit, paditësit.

Baza juridike nuk ka qenë kontestuese sipas pretendimeve me revizion, prandaj kjo gjykatë në këtë pjesë sa i përket zbatimit të dispozitave materiale - juridike është e kufizuar, duke qenë se

deklarimi për bazën është çështje që i referohet disponibilitetet të kërkesave, për të cilën palët mund të disponojnë lirishtë në këtë rast.

Për pjesën e kërkesave për dëmin jomaterial për të cilat është refuzuar revizioni, kjo gjykatë vlerëson se në kuptim të dispozitave materiale - juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë e në përputhje me gjendjen faktike, drejt është zbatuar e drejta materiale, për arsye se në çdo rast për dëmin jomaterial, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jomaterial e që është satisfaksion për të dëmtuarit. Mbi këtë bazë duke e pasur parasysh natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësi, llojin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika, si dhe rrethanat tjera si moshën e paditësit dhe praktikën e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 200 të LMD-së, rezulton se shumata e gjykuara janë në përputhje me qëllimin e kompensimit. Në këtë rast vlerësohet se gjykata e shkallës së parë dhe të dytë kanë vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që kanë pësuar paditësi, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për të, dhe duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancave me të ulëta, me rastin e vendosjes, drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadiës rreth kompensimit të dëmit material dhe atë: për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë dhe për ushqimin e përforcuar, për arsye se me nenin 195 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit lezonim trupor, ose ia prish shëndetin ka për detyrë t’i kompensojë shpenzimet e mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit. Në këtë rast paditësit i takon e drejta në kompensimin e dëmit material, për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar, përkundër faktit se paditësi për këto kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale, kjo gjykatë vlerëson se duke u nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave në Kosovë, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloj dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, gjykata ka konstatuar se në këtë rast paditësi ka pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë në kohëzgjatje prej 5 ditë dhe ushqimi të përforcuar në kohëzgjatje prej 16 ditë, dhe të njëjtit i takon ky lloj kompensimi i kërkuar në shumata e gjykuara. Ndërsa në këtë rast lartësia e kërkesës për këto kategori të dëmit është reale në raport me kohëzgjatjen për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare dhe sipas pretendimeve në revizion, për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të nenit 224 paragrafi 1 të LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, prandaj

duke vlerësuar se shumata e gjykuara sa i përket dhimbjeve shpirtërore në raport me cenimin e nderit dhe autoritetit nuk ishin në përputhje me qëllimin të cilit i shërben kompensimi, sepse në këtë rast nuk kemi të bëjmë me cenim të nderit dhe autoritetit, prandaj u vendos që sa i përket kësaj pjese të kërkesëpadisë, të ndryshohen aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta, sa i përket dëmit jomaterial duke u vendosur që kjo pjesë e kërkesëpadisë të refuzohet si e pabazuar, për arsye se:

Me nenin 198 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush e shkel nderin ose kush nxjerr apo përhapë thënie të rreme mbi të kaluarën mbi diturinë, mbi aftësinë e personit tjetër ose mbi ndonjë gjë tjetër, ndërsa e di ose do të duhej ta dinte se janë të rreme, e në këtë mënyrë i shkakton dëm material ka për detyrë t’ia kompensojë atë ”.

Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore dhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë, sa i përket pjesës së ndryshuar me revizion, me rastin e shkaktuar në incidentin e datës 21.07.2011 në fshatin G. e U., për faktin se sulmi ndaj personit zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës zyrtarë nënkupton cenim të nderit apo autoritet, por nënkupton veprë penale, si pasojë e së cilës këtu paditësi ka pësuar lëndim të lehtë trupor, për çka edhe i takon e drejta për të kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jomaterial siç është gjykuar në këtë rast. Andaj në këtë rast nuk kemi të bëjmë me cenim të nderit dhe të autoritetit, ashtu siç përcaktohet me nenin 198 të LMD-së, e rrjedhimisht paditësit nuk i takon as e drejta në kompensim sa i përket kësaj pjese të kërkesëpadisë.

Në këtë kontekst janë pranuar pjesërisht pretendimet sipas revizionit nga përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve, për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate, për këtë pjesë të kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë dhe të dytë në përputhje me gjendjen faktike kanë aplikuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale, në pjesën në të cilën është ndryshuar me anë të këtij aktgjykimi, duke i’u referuar nenit 198 dhe 200 të LMD-së.

Duhet theksuar se kjo gjykatë vendosi si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, në emër të dhimbjeve të përjetuara shpirtërore, për cenimin e nderit dhe autoritetit me rastin e sulmit fizik, fyerjeve dhe ofendimeve në vende publik gjatë orarit të punës, të pësura në incidentin e datës 21.07.2011, vetëm shumën në lartësi prej 500 €, për arsye se gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e goditur sipas revizionit e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë, sa i përket kësaj pjese të kërkesëpadisë, ndaj të cilit paditësi nuk ka paraqitur revizion, e nga kjo rezulton se kërkesa e paditësit, sa i përket kësaj pjese të kërkesëpadisë ka mbetur vetëm shumata në lartësi 500 €, të cilën kjo gjykatë e ka refuzuar në tërësi.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitura në revizion nga të paditurit nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike ”.

Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e tjera të revizionit, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 dhe 224 paragrafi 1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2019:163103  
Datë: 07.06.2024  
Numri i dokumentit: 05794211

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Rev.nr.184/24, datë 21.05.2024.

Kryetar i kolegjit  
Rrustem Thaqi